Adresa: Bulevardi Dëshmoret e Kombit, Kullat Binjake, Kati 2, Kodi Postar 1000, Tiranë. Tel: +355 4450378, Fax: +355 44 500 379, E-mail: info@noacontrol.al

# *Deklaratë Angazhimi*

*"Noa Control" Sh.p.k*, Tiranë do të jetë e angazhuar të arrijë dhe të mbajë një standard të lartë profesional të cilësisë, duke përmbushur të gjitha kërkesat përkatëse ligjore si dhe politikën e saj të sigurisë e mjedisit gjatë kryerjes së aktiviteteve të saj.

Noa Control ofron shërbimet e Çertifikimit të personave, në respektim të rëndësisë së parimit të paanshmërisë, duke marre gjithë masat e nevojshme për shmangien dhe minimizimin e risqeve që mund të cenojnë paanshmërinë, duke menaxhuar konfliktin e interesit dhe duke garantuar objektivitetin në gjithë aktivitet e saj të certifikimit, në mënyrë profesionale, të paanshme, transparente dhe premton përmirësim të vazhdueshëm të performancës së saj në përputhje me standardet dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë së *"Noa Control" Sh.p.k*, është i planifikuar, i dokumentuar, i zbatuar dhe i kontrolluar. Ne do të kontrollojmë zbatimin e politikës së cilësisë dhe politikave të tjera nëpërmjet rezultateve të auditimeve të brendshme dhe të jashtme, kënaqësisë së klientëve dhe autoriteteve, statusit të efektivitetit të veprimeve korrigjuese dhe parandaluese, masave që rrjedhin nga rishikimi i menaxhimit, ndryshimeve që mund të ndikojnë në sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe rekomandimeve për përmirësim.

Stafi i *"Noa Control" Sh.p.k*, është i vetëdijshëm që sistemi i menaxhimit të cilësisë duhet të zbatohet pa shmangie dhe mangësira dhe do të zbatohet nga çdo person i cili është i përfshirë në aktivitetin e çertifikimit.

*"Noa Control" Sh.p.k*, është e angazhuar të mirëpresë çdo apelim të aplikanteve apo kandidateve si dhe çdo ankese nga çdo individ/organizate lidhur me aktivitetin e çertifikimit. Noa Control eshte i pergjegjshem, ka autoritetin dhe nuk delegon vendimet e saj lidhur me çertifikimin perfshire plotesimin, mbajtjen, zgjerimin dhe zvogelimin e fushes se çertifikimit dhe pezullimin ose mohimin e çertifikimit.

Gjithashtu Noa Control nuk nënkontrakton vendimmarrjen. NOA CONTROL ofron shërbimin e trajnimit por duke marre gjithë masat e nevojshme të dokumentuara për shmangien dhe minimizimin e riskut të cenimit të paanshmërisë për evidentimin.

Ne jemi të bindur që përdorimi i parimeve dhe praktikave manaxheriale drejt vlerave arrijnë

rezultate më eficente dhe konkurruese dhe për rrjedhim sigurojnë rritje të qëndrueshme dhe fitimprurëse.

Reputacioni i Noa Control është një nga asetet tona më të vlefshme dhe një element kyc në zhvillimin e shërbimeve. Për këtë qëllim, paanshmëria, pavarësia dhe integriteti janë gurët e themelit të Kodit tone të Etikes.

Të gjitha vlerat tona janë ndarë dhe nënshkruar nga stafi ynë, duke ri-forcuar kështu unitetin dhe kohezionin, që na ndihmon për të arritur objektivat tanë strategjikë të rritjes së qëndrueshme dhe fitimprurëse.

Jemi të ndërgjegjshëm që vetëm një staf i trajnuar dhe kompetent është çelsi për sigurimin e një performance të larte të kryerjes së shërbimeve të çertifikimit. Ne do të organizojmë trajnime të vazhdueshme për stafin tonë (të brendshëm dhe të jashtëm) dhe do të kontrollojmë efektivitetin e tyre. Për realizimin e politikës së cilësisë *"Noa Control" Sh.p.k*, ka përcaktuar objektivat e cilësisë të cilat i bashkëngjiten kësaj politike.

**ADMINISTRATORE**
**NOA CONTROL SH.P.K.**

**Datë: 05.01.2026**

NIPT: L51622005C NOA control Sh.p.k Tirana - Albania